



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Matematikë (Gjimnaz)

Varianti A

Shënim:

- Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdeshshëm, sidomos në pyetjet me zhvillim dhe arsyetim, të cilat kanë më shumë se një mundësi zgjidhjeje.
- Çdo zgjidhje e dhënë nga nxënësit ndryshtë nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, do të marrë pikët përkatëse.
- Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa vlerësohen me 1 pikë.

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

| Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---------------------|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Alternativa e saktë | C | D | B | B | C | C | B | B | D | B |
| Pyetja | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| Alternativa e saktë | C | A | C | A | A | A | D | B | A | D |

Pyetjet me zhvillim dhe arsyetim**Pyetja 21****2 pikë****Përgjigje e plotë:**

Nëse shënojmë me x numrin e panjohur, fjalia matematikore e dhënë shkruhet:

$$2x = 75\% \text{ e } 24 \Leftrightarrow 2x = 0,75 \times 24 \Leftrightarrow$$

$$\Leftrightarrow 2x = 18 \Leftrightarrow x = 9$$

$$(\text{Nxënësi mund të shprehë } 75\% = \frac{3}{4})$$

2 pikë

Nëse nxënësi:

a) ka shtruar saktë ekuacionin si shprehje matematikore të pohimit të dhënë:

$$2x = 0,75 \times 24 \text{ ose } 2x = \frac{3}{4} \times 24$$

b) ka zgjidhur saktë ekuacionin duke gjetur vlerën e numrit të panjohur, $x = 9$.**1 pikë**

Nëse nxënësi ka përmbushur vetëm pikën a)

$2x = 0,75 \times 24 \text{ ose } 2x = \frac{3}{4} \times 24$, por gabon në kryerjen e veprimeve për gjetjen e numrit të kërkuar.

OSENëse nxënësi shkruan vetëm $x = 9$.**OSE**Nëse nxënësi ka njehsuar saktë vetëm $75\% \text{ e } 24 = 18$ **0 pikë**Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.**Pyetja 22a****2 pikë****Përgjigje e plotë:**


Për shprehur vektorin \vec{AB} , sipas rregullit të trekëndëshit, mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned}\vec{AB} &= \vec{AO} + \vec{OB} \\ &= -\vec{OA} + \vec{OB} \\ &= -2\vec{a} + 2\vec{b} \\ &= 2\vec{b} - 2\vec{a}\end{aligned}$$

Ndërsa:

$$\begin{aligned}\vec{EA} &= \vec{EO} + \vec{OA} \\ &= \vec{OB} + \vec{OA} \rightarrow (\vec{EO} = \vec{OB}) \\ &= 2\vec{b} + 2\vec{a}\end{aligned}$$

$$\text{OSE } \vec{AB} = \vec{OB} - \vec{OA} = 2\vec{b} - 2\vec{a}$$



2 pikë Nëse nxënësi: a) ka shkruar lidhjen

$$\begin{aligned}\overrightarrow{AB} &= \overrightarrow{AO} + \overrightarrow{OB} \\ &= -\overrightarrow{OA} + \overrightarrow{OB} \\ &= -2\vec{a} + 2\vec{b} \\ &= 2\vec{b} - 2\vec{a} \\ \text{apo } \overrightarrow{AB} &= \overrightarrow{OB} - \overrightarrow{OA} = 2\vec{b} - 2\vec{a}\end{aligned}$$

b) ka shkruar lidhjen

$$\begin{aligned}\overrightarrow{EA} &= \overrightarrow{EO} + \overrightarrow{OA} \\ &= \overrightarrow{OB} + \overrightarrow{OA} . \\ &= 2\vec{b} + 2\vec{a}\end{aligned}$$

1 pikë Nëse nxënësi ka përbushur saktë vetëm një nga pikat a) **OSE** b).

0 pikë Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 22b

2 pikë

Përgjigje e plotë:

$$\begin{aligned}\overrightarrow{OM} &= \overrightarrow{OA} + \overrightarrow{AM} = \\ &= \overrightarrow{OA} + \frac{\overrightarrow{AB}}{2} = \\ &= \overrightarrow{OA} + \frac{2\vec{b} - 2\vec{a}}{2} = \quad \text{Meqenëse M mesi i AB} \Rightarrow \overrightarrow{AM} = \frac{\overrightarrow{AB}}{2} \\ &= 2\vec{a} + \frac{2\vec{b} - 2\vec{a}}{2} = \\ &= 2\vec{a} + \vec{b} - \vec{a} = \vec{a} + \vec{b}\end{aligned}$$

2 pikë Nëse nxënësi: a) ka shkruar lidhjen $\overrightarrow{AM} = \frac{\overrightarrow{AB}}{2} = \frac{2\vec{b} - 2\vec{a}}{2}$

b) ka shprehur $\overrightarrow{OM} = \overrightarrow{OA} + \overrightarrow{AM} = \overrightarrow{OA} + \frac{\overrightarrow{AB}}{2} = 2\vec{a} + \vec{b} - \vec{a} = \vec{a} + \vec{b}$

1 pikë Nëse nxënësi ka përbushur saktë vetëm një nga pikat a) **OSE** b)

$$\overrightarrow{AM} = \frac{\overrightarrow{AB}}{2} = \frac{2\vec{b} - 2\vec{a}}{2} = \vec{b} - \vec{a} \text{ apo } \overrightarrow{OM} = \overrightarrow{OA} + \overrightarrow{AM} = \overrightarrow{OA} + \frac{\overrightarrow{AB}}{2} .$$

0 pikë Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.


Pyetja 23**3 pikë****Përgjigje e plotë:**Kemi: $A = \{1, 2, 7, 9\}$

Shprehim me emërtim bashkësitë e dhëna me përshkrim:

$$B = \{x \in N / x < 9\} = \{1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8\}$$

$$T = \{x \in N / x \leq 10\} = \{1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10\}$$

Bëjmë shpërndarjen e elementeve në diagramë.

Meqenëse zona e hijezuar paraqet bashkësinë $A \cup B$,vemë re se bashkësia: $C = \{x \in T / x \notin A \cup B\} = \{10\} \Rightarrow n(C) = 1$ (zona e pahijezuar).**3 pikë**Nëse nxënësi: a) ka paraqitur saktë dhe me emërtim njërën nga bashkësitë **B OSE T**.

b) ka plotësuar plotësisht saktë në diagram njërën nga bashkësitë:

$$A = \{1, 2, 7, 9\}, B = \{1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8\}, A \cap B,$$

$$\{x \in T / x \notin A \cup B\} = \{10\}$$

c) ka shkruar se numri i elementeve nga bashkësia T , të cilat nuk bëjnë pjesë në $A \cup B$, është 1.

$$\text{Pra } \{x \in T / x \notin A \cup B\} = \{10\} \Rightarrow n(x \in T / x \notin A \cup B) = 1.$$

2 pikë


Nëse nxënësi ka përbushur saktë a) dhe b).

1 pikëNëse nxënësi ka përbushur saktë vetëm njërën nga pikat: a) **OSE** b).**0 pikë**Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 24**3 pikë****Përgjigje e plotë:**

Meqenëse $DC \parallel AB$, si baza të trapezit, atëherë $\Delta AEB \sim \Delta DEC$,

$$\text{sepse: } \begin{cases} m(\hat{A}BE) = m(\hat{D}CE) \rightarrow \text{si kënde pëgjegjës} \\ m(\hat{A}EB) = m(\hat{D}EC) \rightarrow \text{i përbashkët} \end{cases} \Leftrightarrow (\text{Rast i I})$$



Ndërtojmë raportin e brinjëve homologe:

$$\frac{ED}{EA} = \frac{DC}{AB} \Rightarrow \frac{x}{7+x} = \frac{5}{12} \Leftrightarrow 12x = 5(7+x) \Leftrightarrow \\ \Leftrightarrow 12x = 35 + 5x \Leftrightarrow 7x = 35 \Leftrightarrow x = 5 \text{ cm}$$

Pra $DC = DE = 5 \text{ cm}$.

Kështu që ΔDEC është dybrinjënjëshëm, meqenëse $DC = DE = 5 \text{ cm}$.

3 pikë

Nëse nxënësi: a) ka provuar ngashmërinë e trekëndëshave $\Delta AEB \sim \Delta DEC$.

b) ka ndërtuar saktë raportin e brinjëve të përpjesëshme.

c) ka treguar se $DC = DE = 5 \text{ cm}$, pavarësisht mënyrës së të shprehurit.

2 pikë

Nëse nxënësi ka përmbushur pikat a) dhe b) **OSE** b) dhe c)

1 pikë

Nëse nxënësi ka përmbushur vetëm njëren prej pikave a) **OSE** b).

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 25**3 pikë****Përgjigje e plotë:**

$V_A \rightarrow$ orientimi i Veriut në pikën e nisjes A


$V_B \rightarrow$ orientimi i Veriut në B

$m(\hat{B}AV_A) = 140^\circ \rightarrow$ kursi n ga A në B

$m(\hat{C}BV_B) = 80^\circ \rightarrow$ kursi n ga B në pikën e mbërritjes C

Meqenëse $m(\hat{B}AV_A) = 140^\circ$ dhe $\vec{V}_A \uparrow\uparrow \vec{V}_B$, atëherë

$m(V_B \hat{B}A) = 180^\circ - 140^\circ = 40^\circ$, atëherë $m(A \hat{B}C) = 80^\circ + 40^\circ = 120^\circ$



Në ΔABC zbatojmë teoremën e Kosinusit:

$$\begin{aligned} AC^2 &= AB^2 + BC^2 - 2AB \times BC \times \cos \alpha \\ &= 12^2 + 20^2 - 2 \times 12 \times 20 \times \left(-\frac{1}{2}\right) \\ &= 144 + 400 + 240 \\ &= 784 \Rightarrow AC = \sqrt{784} \\ &= 28 \text{ cm} \end{aligned}$$

3 pikë

Nëse nxënësi:

- a) ka ndërtuar saktë figurën, shoqëruar me këndet përkatëse, (figura e plotësuar nënkupton përllogaritjen e këndeve të nevojshme).
- b) ka shkruar saktë teoremën e Kosinusit për njehsimin e distancës AC:
$$AC^2 = AB^2 + BC^2 - 2AB \times BC \times \cos \alpha$$
- c) ka kryer saktë veprimet dhe jep vlerën e saktë të distancës së çiklistit nga pika e tij e nisjes.

2 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur pikat a) **DHE** b).

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm njëren nga pikat a) **OSE** b).

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 26a

1 pikë

Përgjigje e plotë:

$$g(1) = 1 + 1 = 2 \Rightarrow f(g(1)) = f(2) = 2^2 - 9 = -5$$

1 pikë

Nëse nxënësi njehson saktë $f(g(1)) = f(2) = (2)^2 - 9 = -5$.

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 26b**2 pikë****Përgjigje e plotë:**

$$f(g(x)) = g^2(x) - 9 = (x+1)^2 - 9$$

$$f(g(x)) = 0 \Leftrightarrow (x+1)^2 - 9 = 0 \Leftrightarrow (x+1)^2 = 9 \Leftrightarrow$$

$$\Leftrightarrow (x+1) = \pm 3 \Leftrightarrow x+1 = 3 \text{ ose } x+1 = -3 \Leftrightarrow$$

$$x_1 = 2 \text{ ose } x_2 = -4$$

2 pikë

Nëse nxënësi: a) ka gjetur saktë formulën e $f(g(x))$ OSE ka shtruar ekuacionin $(x+1)^2 - 9 = 0$

b) ka zgjidhur saktë ekuacionin:

$$(x+1)^2 - 9 = 0 \Leftrightarrow (x+1)^2 = 9 \Leftrightarrow (x+1) = \pm 3 \Leftrightarrow x_1 = 2 \text{ ose } x_2 = -4$$

$$x_1 = 2 \text{ ose } x_2 = -4$$

❖ Nëse nxënësi ka gjetur në hapësirën e ushtrimit 26a, funzionin përbërje

$$f(g(x)) = g^2(x) - 9 = (x+1)^2 - 9, \text{ kjo veprimtari vlerësohet tek 26b.}$$

❖ Nxënësi mund ta ketë zgjidhur ekuacionin me formulën kuadratike.

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur saktë vetëm pikën a)

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare OSE ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 27**3 pikë****Përgjigje e plotë:**


Zona plane, të cilës do t'i njehsojmë syprinën, kufizohet nga vijat:

$$\begin{cases} y = x^2 + 1 \\ y = 0 \\ x = 0 \\ x = 2 \end{cases}$$

$$\text{Meqenëse } x^2 + 1 > 0, \forall x \in [0; 2] \Rightarrow S = \int_0^2 (x^2 + 1) dx$$

$$S = \int_0^2 (x^2 + 1) dx = \left(\frac{x^3}{3} + x \right) \Big|_0^2 = \left(\frac{2^3}{3} + 2 \right) - \left(\frac{0^3}{3} + 0 \right) =$$

$$= \left(\frac{8}{3} + 2 \right) - (0) = \frac{14}{3} \text{ nj}^2$$



| | | |
|--------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 3 pikë | Nëse nxënësi: | a) ka shkruar saktë integralin e caktuar për njehsimin e syprinës së kërkuar: $S = \int_0^2 (x^2 + 1) dx$ |
| | | b) ka njehsuar saktë integralin e pacatruar: $\int_0^2 (x^2 + 1) dx = \left(\frac{x^3}{3} + x \right) \Big _0^2$ |
| | | c) ka kryer saktë veprimet, duke gjetur vlerën e saktë të syprinës: $S = \left(\frac{2^3}{3} + 2 \right) - \left(\frac{0^3}{3} + 0 \right) = \frac{14}{3} nj^2$ |
| 2 pikë | Nëse nxënësi ka përmbushur saktë pikat a) dhe b) OSE b) dhe c)-jo të plotë, p.sh; nxënësi ka gabuar në kryerjen e veprimit të fundit. | |
| 1 pikë | Nëse nxënësi ka përmbushur saktë vetëm pikën a). | |
| 0 pikë | Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare OSE ka bërë zgjidhje të gabuar. | |

Pyetja 28a**1 pikë****Përgjigje e plotë:**

$$C = 30M + 40T, \text{ ku:}$$

C – vlera për t'u paguar sipas faturës

M – numri i mesazheve të dërguara = 24

$$T – koha në minuta e bisedave = 15, rrjedhimisht: C = 30 \times 24 + 40 \times 15 = 720 + 600 = 1320 \text{ lekë}$$

1 pikë Nëse nxënësi njehson vlerën e saktë të faturës për 24 mesazhe dhe 15 min kohë bisede:

$$C = 1320 \text{ lekë}$$

0 pikë Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 28b**1 pikë****Përgjigje e plotë:**

Zëvendësojmë të dhënat:

$$\begin{cases} C = 3400 \\ M = 20 \end{cases} \Rightarrow 3400 = 30 \times 20 + 40 \times T \Leftrightarrow 40T = 3400 - 600 \Leftrightarrow$$

$$40T = 2800 \Leftrightarrow T = \frac{2800}{40} = \\ T = 70 \text{ min}$$

1 pikë Nëse nxënësi ka gjetur saktë numrin e minutave T, për $\begin{cases} C = 3400 \\ M = 20 \end{cases}, T = 70 \text{ min}$

0 pikë Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 29**3 pikë****Përgjigje e plotë:**

Tri kufizat e para të vargut aritmetik janë: $a_1 = 5x + 10$, $a_2 = 10$, $a_3 = x + 4$

Meqenëse vargu është aritmetik, kemi:

$$a_2 = \frac{a_1 + a_3}{2} \Rightarrow \frac{5x + 10 + x + 4}{2} = 10 \Leftrightarrow \frac{6x + 14}{2} = 10 \Leftrightarrow$$

$$6x + 14 = 20 \Leftrightarrow 6x = 6 \Leftrightarrow x = 1$$

Praj nga: dy kufizat e panjohura të këtij vargut janë:

$$a_1 = 5x + 10 = 5 + 10 = 15, a_3 = 1 + 4 = 5$$

$$a_1 = 15, a_2 = 10, a_3 = 5$$

3 pikë**3 pikë**

Nëse nxënësi: a) ka shkruar saktë vetinë e vargut aritmetik.

$$a_2 = \frac{a_1 + a_3}{2} \text{ (ose } a_2 - a_1 = a_3 - a_2\text{)}$$

b) ka zgjidhur saktë ekuacionin në varësi të x-it.

c) ka gjetur saktë kufizat e panjohura $a_1 = 15$ dhe $a_3 = 5$.

2 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm a) dhe b) **OSE** b) dhe c)

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm a) vetëm b).

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 30**2 pikë****Përgjigje e plotë:**

Zgjidhim në R inekuacionin $x(x+2) \geq 4(x-1) + x^2$:

$$x(x+2) \geq 4(x-1) + x^2 \Leftrightarrow x^2 + 2x \geq 4x - 4 + x^2 \Leftrightarrow$$

$$2x - 4x \geq -4 \Leftrightarrow -2x \geq -4 \Leftrightarrow x \leq 2$$

Bashkësia e zgjidhjeve: $x \in R / x \in]-\infty; 2]$.

2 pikë

Nëse nxënësi: a) ka kryer saktë shndërrimet e njëvlershme:

$$x(x+2) \geq 4(x-1) + x^2 \Leftrightarrow x^2 + 2x \geq 4x - 4 + x^2$$

b) ka gjetur saktë zgjidhjen e inekuacionit: $2x - 4x \geq -4 \Leftrightarrow -2x \geq -4 \Leftrightarrow x \leq 2$

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm pikën a).

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.


Pyetja 31a 2 pikë**Përgjigje e plotë:**

Dihet se funksioni $y = 3x^2 + 12x$ është monoton rritës për $x \in R / f'(x) > 0$.

$$f'(x) = (3x^2 + 12x)' = 6x + 12$$

Skicojmë grafikun e funksionit derivat: $f'(x) : y = 6x + 12$ dhe vemi re se:

$$6x + 12 > 0 \text{ për } x \in]-2; +\infty[,$$



(intervali i vlerave të x-it, ku grafiku i funksionit derivat ndodhet "sipër" boshit (Ox)).

pra $f'(x) > 0$ për $x \in]-2; +\infty[$, rrjedhimisht funksioni është rritës për $x \in]-2; +\infty[$.

2 pikë

Nëse nxënësi: a) ka gjetur funksionin derivat $y' = 6x + 12$

b) ka zgjidhur saktë $y' > 0$ në mënyrë grafike (ose analitike, si inekuacion i gradës së parë $6x + 12 > 0 \Leftrightarrow 6x > -12 \Leftrightarrow x > -2$, duke dhënë si zgjidhje të situatës bashkësinë $A =]-2; +\infty[$

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm pikën a).

0 pikë

Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 31b**2 pikë****Përgjigje e plotë: to**

Ekuacioni i tangjentes ndaj grafikut $y = 3x^2 + 12x$ në pikën $A(1; 15)$ të vijës, është:

$$y - y_A = f'(x_A)(x - x_A) \quad \text{ose} \quad y - y_A = k_{tg}(x - x_A)$$

$$f'(x_A) = 6x_A + 12 = 6 \cdot 1 + 12 = 18 \quad (\text{koeficienti këndor i tangjentes}) \text{ dhe } f(x_A) = 15$$

$$\text{Kemi: } y - 15 = 18(x - 1) \Leftrightarrow y - 15 = 18x - 18 \Leftrightarrow y = 18x - 3$$

$$\text{Pra ekuacioni i tangjentes së kërkuar është } y = 18x - 3.$$

2 pikë

Nëse nxënësi:

- a) ka njehsuar saktë koeficentin këndor të tangjentes $f'(1) = 6 \times 1 + 12 = 18$
b) ka shkruar saktë ekuacionin e tangjentes.
 $y - y_A = k_{tg}(x - x_A) \Rightarrow$
 $y - 15 = 18(x - 1) \Leftrightarrow y - 15 = 18x - 18 \Leftrightarrow y = 18x - 3$

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm pikën a).

OSENëse nxënësi ka shkruajtur vetëm ekuacionin $y - y_A = k_{tg}(x - x_A)$ si ekuacionin të tangjentes.**0 pikë**Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.**Pyetja 32a****2 pikë****Përgjigje e plotë:**


Shënojmë simbolikisht ngjarjet: (sot)

 $L_1; L_2 \rightarrow$ përkatesisht "ditë e lagësht ditën e parë (sot)" dhe "ditë e lagësht ditën e dytë (nesër)" $T_1; T_2 \rightarrow$ përkatesisht "ditë e thatë ditën e parë (sot)" dhe "ditë e thatë ditën e dytë (nesër)"
$$\begin{cases} L_1 \text{ dhe } T_1 \text{ janë ngjarje të papajtueshme dhe shteruese ndërmjet tyre} \\ L_2 \text{ dhe } T_2 \text{ janë ngjarje të papajtueshme dhe shteruese ndërmjet tyre } \end{cases}$$

Nga situata kemi:

Dita e parë: $P(L_1) = 0,6 \Rightarrow P(T_1) = 1 - 0,6 = 0,4$ Dita e dytë: $P(L_2) = 0,7 \Rightarrow P(T_2) = 1 - 0,7 = 0,3$

Plotësojmë diagramin "pemë":

**2 pikë**

Nëse nxënësi:

- a) ka njehsuar saktë probabilitetet për ditën e parë **OSE** të dytë.
b) ka vendosur saktë në degët e pemës, probabilitet përkatëse.

1 pikë

Nëse nxënësi ka përbushur vetëm pikën a).

0 pikëNëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 32b**1 pikë****Përgjigje e plotë:**

$$P(T_1 \text{ dhe } T_2) = P(T_1) \times P(T_2) = 0,4 \times 0,8 = 0,32$$

pasi T_1 dhe T_2 janë ngjarje të pavarura

1 pikë

Nëse nxënësi ka gjetur saktë probabilitetin e ngjarjes: "sot dhe nesër është ditë e thatë"

$$P(T_1 \text{ dhe } T_2) = 0,4 \times 0,8 = 0,32$$

0 pikëNëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.**Pyetja 33a****1 pikë****Përgjigje e plotë:**

Plotësojmë tabelën duke zbatuar:

$$\text{Mesi i klasës } ([a;b]) = \frac{a+b}{2}$$

| <i>Lartësia (cm)</i> | <i>Denduria (n)</i> | <i>Mesi i klasës (m)</i> |
|----------------------|---------------------|--------------------------|
| $80 \leq h < 100$ | 12 | 90 |
| $100 \leq h < 120$ | 7 | 110 |
| $120 \leq h < 140$ | 8 | 130 |
| $140 \leq h < 160$ | 19 | 150 |

1 pikë

Nëse nxënësi ka plotësuar saktë tabelën me të dhënat për mesin e secilës klasë.

0 pikëNëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.**Pyetja 33b****2 pikë****Përgjigje e plotë:**

$$\text{Mesatarja: } \bar{x} = \frac{m_1 n_1 + m_2 n_2 + m_3 n_3 + m_4 n_4}{N} = \frac{90 \times 12 + 110 \times 7 + 130 \times 8 + 150 \times 19}{46} = 124,78$$

2 pikëNëse nxënësi:
 a) ka shkruar saktë formulën për mesataren aritmetike të shpërndarjes statistikore kur të dhënat e tiparit janë të grupuara.
 b) ka zëvendësuar saktë të dhënat dhe ka gjetur saktë $\bar{x} = 124,78$ **1 pikë**Nëse nxënësi ka përmushur saktë vetëm pikën a) **OSE** vetëm pikën b).**0 pikë**Nëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.

Pyetja 33c 2 pikë**Përgjigje e plotë:**Klaza modale e shpërndarjes është klasa e katërt në tabelë, $140 \leq h < 160$, si klasë me dendurinë më tëmadhe ($n_4 = 19$).Gjerësia e kësaj klase është: $Gjerësia e klasës ([140; 160[) = 160 - 140 = 20$

Densiteti i kësaj klase është: $d_4 = \frac{n_4}{gjerësi klase} = \frac{19}{20} = 0,95$

2 pikë

Nëse nxënësi:

- a) ka identifikuar saktë klasën modale të shpërndarjes dhe ka gjetur saktë gjerësinë e saj.
 b) ka gjetur vlerën e saktë të densitetit të klasës së kërkuar:

$$d_4 = \frac{n_4}{gjerësi klase} = \frac{19}{20} = 0,95$$

1 pikë

Nëse nxënësi ka përmbrushur vetëm pikën a) ose vetëm pikën b).

0 pikëNëse nxënësi nuk ka shkruar fare **OSE** ka bërë zgjidhje të gabuar.